



## 2.06 - Përsosmëria në shërbesë

(2.06 - Excellence in Ministry)

### 1. Një standard përsosmërie në shërbesë

**Shkrimet bazë:**

**Mat.5:48**

*Jini, pra, të përkryer, (duke u rritur në maturi të plotë të mendjes dhe karakterit, duke arritur lartësinë e duhur të virtetit dhe integritetit), ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej.*

**Efes.4: 1**

*Unë, pra, i burgosuri për Zotin, ju bëj thirrje që të ecni (të jetoni) denjësisht sipas thirrjes (hyjnore) për të cilën u thirrët (me sjellje që është për thirrjen ndaj shërbimit të Perëndisë.*

Si të krishterë ne kërkojmë përsosmëri nga Perëndia; përkushtim të plotë, angazhim, besueshmëri dhe sukses. **Meqenëse presim përsosmëri nga Perëndia, ne gjithashtu duhet të jemi të gatshëm të kërkojmë të njëjtën përsosmëri nga vetja jonë (pavarësisht se në çfarë lloj shërbese jemi të thirrur).**

**Përsosmëria në shërbesë**

- nuk do të tolerojë mosbesimin, dështimin apo të zgjedhësh rrugën e lehtë.
- do të paguajë çdolloj çmimi për të bërë punën sipas mënyrës së Perëndisë.
- do të veprojë me dedikim dhe integritetit.
- do të tregojë ndershmëri dhe angazhim absolut.
- do të përfaqësojë **Jezusin** në botë.

### 2. Gjashtë hapat drejt përsosmërisë.

#### Hapi 1: dedikim - është vendimi yt.

- përkushtimi i vërtetë është një vendim i cilësisë, një vendim ku nuk ka kthim prapa
- përkushtimi është i bazuar në angazhim dhe jo në ndjenja.
- kur ti merr një vendim për angazhim, Perëndia siguron fuqinë, ashtu si tek rilindja.

**Gjej vendin tënd në Trupin e Krishtit**

- Bibla thotë se thirrjet e Perëndisë janë të pakthyeshme (Rom.11:29)  
- Perëndia nuk do ta revokojë thirrjen në jetën tënde. Gjeje atë dhe hyr në të sa më shpejt që të jetë e mundur.  
- zgjidh të jesh një enë nderi

**2 Tim. 2: 20-21**

*"Në një shtëpi të madhe nuk ka vetëm enë prej ari dhe argjendi por edhe prej druri dhe balte; disa për të nderuar; të tjerat për të mos nderuar. Pra, në qoftë se dikush pastrohet nga këto gjëra, do të jetë një enë nderi".*

**Përkushtohu t'i pëlqesh Perëndinë**

- mëso ato gjëra që i pëlqejnë Perëndisë dhe ato që nuk i pëlqejnë Atij  
- *Por pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij* (Heb.11:6)  
- *i drejti do të jetojnë me anë të besimit* (Rom.1:17)



## 2.06 - Përsosmëria në shërbesë

- kur e mundim (1 Gjonit 5: 4-5)
- mos ecja në fitore është gjithashtu ofenduese ndaj Perëndisë (Heb.3: 16,17)
- të ecësh në dashurinë e Perëndisë i pëlqen Atij, *edhe besimi vepron me dashuri* (Gal.5: 6)
- ecja në shkelje, grindje dhe ndarje nuk i pëlqen Perëndisë, sepse grindjet do të pengojnë besimin tënd, dhe bëjnë që të kapesht rob nga veprat e satanait (2 Tim.21-24), dhe ndalon funksionimin e nëntë dhuntive të Frymës në jetën e besimtarit (1 Kor.13: 1-3 dhe Jakobi 3:16)

### Dedikohu jetës në lutje

- Lutja është themeli i suksesit për çdo të krishterë.
- Jezusi kaloi shumë kohë me Atin e Tij në lutje dhe miqësi (Marku 1:35 & Luka 6:12)
- Pak lutje pak fuqi, shumë lutje shumë fuqi!
- Ki bashkësi me Perëndinë dhe ndërto një marrëdhënie me Të.

### Hapi 2: Qartësia e qëllimit

Qëllimi **ynë i vetëm** si shërbëtorë të Perëndisë është që të plotësojmë nevojat e njerëzve.

- Një mendje jo e zhdyzuar është shumë e rëndësishme, sepse një njeri me dy mendje është i paqëndrueshëm në gjithë rrugët e veta dhe ai nuk merr asgjë nga Zoti. (Jakobi 1: 5-8)
- Një njeri me një mendje të vetme është dikush që merr vendime cilësore dhe qëndron në to përgjithmonë.
- Mos hezito të ecësh në besimin tënd. (Luka 8: 22-25)
- Prediko fjalën; ngul këmbë me kohë e pa kohë... (2 Tim. 4: 2, 5)
- Shenjat dhe mrekullitë do të ndjekin fjalën që predikohet. (Marku 16:15)

### Hapi 3: Ndiq drejtimin e Frymës së Shenjtë

- Vendos të jesh i udhëhequr nga Fryma e Shenjtë përmes Fjalës dhe jo nga natyrshmja. *Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t'ju prijë në çdo të vërtetë...* (Gjoni 16:13)
- Mos u mbështet në të kuptuarit tënd, mëso të ndjekësh udhëheqjen e Frymës së Shenjtë brenda teje. *Sepse të gjithë ata që udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë janë bij të Perëndisë.* (Rom.8:14)
- Ti duhet të jesh tërësisht i mbështetur dhe i varur nga Fjala e Perëndisë (Kolosianëve 3:16)
- Ji i udhëhequr nga Fryma dhe i kontrolluar nga fjala. *Ti duhet ta lejosh Fjalën e Krishtit të banojë në ty begatisht në çdo dituri* (Kol. 3:16)

### Hapi 4: Hiqi gjërat e botës.

#### Gjoni 17:16, 17

Jezusi u lut për dishepujt e Tij, *Ata nuk janë prej kësaj bote, ashtu sic unë nuk jam nga kjo botë. Shenjtëroji me të vërtetën tënde: fjala jote është e vërteta*

- **Të shenjtërosh do të thotë "të ndash"**
- Për të patur përsosmëri në shërbesë ne duhet të heqim çdo gjë të botës nga jeta jonë deri sa të mos mbetet asgjë tjetër veç Fjalës së Perëndisë.
- Hidh tutje çdo mëkat ..... *ti je drejtësia e Perëndisë...* (2 Kor.5:21)
- Hidh tutje shpalljet negative, shpall Fjalën e Perëndisë në gojën tënde. (Fjalët e urta 18:21)
- Hidh tutje plehurat frymërore, ushqehu me Fjalën e Perëndisë dhe agjëro fjalën e botës.
- Largo shqetësimet e botës dhe besoji Perëndisë për të përmbushur nevojat e tua, Fjala do të të ndajë ty nga bota. *Hidhi të gjitha shqetësimet tuaja mbi të, sepse Ai kujdeset për ju....* (1 Pjet.5:7)



## 2.06 - Përsosmëria në shërbesë

### Hapi 5: Trego kujdes për Fjalën, ditë e natë

- Të kujdesesh për Fjalën do të sjellë disa efekte në shërbesën tënde, të cilat nuk do të mund t'i marrësh në një mënyrë tjetër. (Fjalët e urta 4: 20-23 & Joz.1: 8)
- Ti do të marrësh miratimin e Perëndisë (stoli hiri), ndërsa kërkon mençurinë e Perëndisë. (Fjalët e urta 4: 5-9)
- Ti do të rrisësh besimin tënd si dhe të kuptuarit tënd se si të përdorësh besimin tënd.
- Kur të lartësosh fjalën, njerëzit do të çlirohen.
- Lartësimi i Fjalës do të të ngrejë në pozitë dhe do të sjellë në një vend nderi. (1 Pjet.5: 6, 7)
- Fjala të ndihmon për të kontrolluar mishin dhe për të trajnuar shqisat për të dalluar të mirën dhe të keqen. (Heb.5: 12-14)
- Duke vazhduar të vendosësh Fjalën e Perëndisë në mendjen, frymën dhe trupin tënd, në fund ti do të arrish në atë pikë ku Fjala i kontrollon të treja. (Rom.12: 1-2)

### Hapi 6 Kalo kohë në agjërim

#### 1 Tim.2: 1-2

**Të bëj thirrje, pra, para së gjithash që të bëhen përgjërime, lutje, ndërhyrje dhe falënderime për të gjithë njerëzit, për mbretërit e për të gjithë ata që janë në pushtet që të mund të shkojmë një jetë të qetë dhe të paqetë me çdo perëndishmëri dhe nder.**

- Qëllimi i agjërit nuk është të ndikojmë Perëndinë për të vepruar për ne. Heqja dorë nga ushqimi atij nuk i bën përshtypje. Qëllimi i tij është të ndalojmë ndikimin e mishit tonë, për të qenë në një mendje me Frymën.
- Agjërimi na ndihmon të marrim nga Perëndia, por nuk e shtyn Perëndinë për të vepruar.
- Sido që të jetë, vendose me anë të besimit dhe shpalle para se të hysh në agjërim. Ki pritshmëri për ta marrë atë. Perëndia do të shohë në fshehtësi dhe ti do të marrësh haptazi. (Mat.6: 17-18)

### Mënyra e duhur për të agjëruar:

- (1) Vendos qëllimin e agjërit para se të fillosh.
- (2) Shpalle agjërimin përpara Zotit, që të mos jesh i tunduar ta thyesh atë.
- (3) Përpara agjërit besoj që do të marrësh shpërblimin e premtuar nga Jezusi tek Mateu 6:18.  
- ti nuk do të marrësh sepse po agjëron. Ti do të marrësh sepse ke besuar me besim. Agjërimi është një ndihmë për të marrë.
- (4) Shërbeji Zotit ndërsa agjëron nëpërmjet lavdërimit dhe adhurimit.
- (5) Shërbeju të tjerëve gjatë dhe pas agjërit, ashtu si Zoti të drejton.
- (6) Ki pritshmëri për ndihmë nga engjëjt. (Mat.4:11)

### Një Frymë Përsosmërie

**Vendimi yt për të ecur në përsosmëri në shërbesë do të varet nëse do të kesh një frymë përsosmërie. Vendos të bësh më të mirën tënde me anë të besimit dhe ki pritshmëri që Perëndia do të bëjë më të mirën e Tij për ty.**

## JEZUSI ËSHTË ZOT!